

Çfarë duhet të dijnë  
fëmijët për gjykatën?



**Libër ilustrues për  
fëmijë**



Ambasada e SHBA-ve, Prishtinë  
Department i Drejtësisë i SHBA-ve



**Cfarë duhet të dijnë  
fëmijët për Gjykatën?**

## **Libër ilustrues për fëmijë**

**Pregatitur nga:**

Benina Kusari- Specialiste ligjore

Eliza Thana- Menaxhere e programit për viktime/dëshmitarë

**Prishtinë  
2015**

*Ky libër i përket:*



### *Çfarë përmban ky libër?*

1. Tabela e Permbajtjes	1
2. Hyrje	2
3. Ushtrimi nr.1 –Porosia e fshehur e Markut, Tonit dhe Anës	3
4. Çfarë është Ligji? Çfarë është Gjykata dhe pse njerëzit shkojnë atje	4
5. Kush është Gjykatësi?	5
6. Kush mund të jetë Dëshmitar dhe Pse?	6
7. Ushtrimi nr.2 - Fytyrat që tregojnë ndjenjat – ilustrim	7
8. Kush janë Prokurori dhe Avokati?	8
9. Ushtrimi nr.3 - Lidhja e pikave - ilustrim	9
10. Kush është viktimja dhe kush është i Pandehuri?	10
11. Ushtrimi nr.4 - Gjej cilat janë dallimet mes fotove të ngjajshme	11
12. Oficeri i Policisë- Mbrojtësi i Viktimave- Punëtori Social	12
13. Ushtrimi nr.5 – Loja me fjalë	13
14. Ushtrimi nr.6 – Salla e gjykimit	14
15. Procesi i gjykimit	15
16. Sqarime për disa shprehje tjera që keni lexuar në përmbledhje:	16
17. Ushtrimi nr.7 - Loja me Kombinime	17
18. Përgjigjet e pyetjeve nga ushtrimet	18

## **HYRJE**

***Ne po shkojmë në Gjykatë.  
Ejani me ne dhe të mësojmë se çfarë duhet të  
dijmë?***

Ne jemi Marku, Toni dhe Ana. Ne jemi shokë të ngushtë. Misioni ynë është që tu mësojmë juve gjithçka që ju duhet të dini për Gjykatën dhe njerëzit që punojnë aty. Do të ju tregojmë se kush është Gjyqtari, cila është detyra e Prokurorit dhe Avokatit, cili është roli i Dëshmitarit, etj. Kjo është një informatë e dobishme të cilën duhet ta dijë çdo fëmijë. Por, kjo është informatë edhe më e mirë për ata fëmijë që në ndonjë kohë për një arsye apo tjetër do tu duhet të shkojnë në Gjykatë për të dëshmuar si Dëshmitarë.



Pasi të mësoni këto dhe shumë gjëra të tjera shpresojmë se do ta keni më lehtë të kuptoni se çka është Gjykata dhe pse njerëzit shkojnë atje posaqërisht kur ata shkojnë atje për shkak se është kryer një vepër penale.

Për t`ju bërë më argëtuese këtë përvojë në libër ne kemi përfshirë edhe disa ushtrime dhe lojëra tjera të cilat janë mjaft argëtuese.

## LE TË FILLOJMË...

### Ushtrimi Nr.1

## POROSIA E FSHEHUR E MARKUT, TONIT dhe ANËS

14 6 27 18

15 6

26 7 15 6 16 4 12 6

9 11 24 3 13 1

16 7

13 7 23 7

14 11 2 7 20

4 18

23 7

8 11 23 18 22

15 7

22 25 15 7

17 18 10 25 20 11

19 7 20

14 11 9 11 16

5 6

9 28 13 1 23 7 16

Secili nga numrat e mësipërm përfaqësojnë një shkronjë. Këta numra janë të shënuar më poshtë. Detyra juaj është të zëvendësoni numrat me shkronjat përkatëse. Pasi të bëni këtë ju do të fitoni tekstin e fshehur.

### Numrat për shkronjat e fshehura:

1- A	8 - F	15- M	22- Sh
2- B	9 - Gj	16- N	23- T
3- Ç	10 - H	17- Nj	24- Th
4- D	11 - I	18- O	25- U
5- Dh	12 - J	19- P	26- V
6- E	13 - K	20- R	27- X
7- Ë	14 - L	21- S	28- Y

{Për të shikuar përgjigjen e saktë shiko përgjigjen në fund të librit}

## **ÇFARË ËSHTË LIGJI**

**LIGJ** - janë rregullat e shkruara të cilat përcaktojnë sjelljen e njerëzve. Ligji është i ngjajshëm me rregullat që ju duhet të respektoni në shkollë apo shtëpi, vetëm se ligji duhet respektuar nga të gjithë qytetarët pa përjashtim. Respektimi i ligjit nga të gjithë na mundëson që të gjithë të jetojnë të sigurtë. Edhe ti si qytetar i këtij vendi duhet të lajmërosh çdoherë kur dikush e shkel ligjin. Nëse dikush nuk e respekton ligjin ai apo ajo do të ndëshkohet nga gjykata.



## **ÇFARË ËSHTË GJYKATA?**

**dhe**

## **PSE NJERËZIT SHKOJNË ATJE?**



**GJYKATA** është vendi ku vendoset për drejtësinë. Aty punojnë Gjykatësit dhe nëpunësit tjerë gjyqësor.

Njerëzit shkojnë në Gjykatë për shumë arsye. Disa shkojnë për të bërë një kërkesë ligjore; tjerët për të dëshmuar si dëshmitar apo si viktimë e tjera.

Edhe personat që shkelin ligjin duhet të paraqiten para gjykatësit për tu përgjigjur për veprimet e veta. Gjykatësi është ai që vendos për dënimin e këtyre personave.

Në vazhdim do të flasim për disa nga njerëzit që punojnë në gjykatë dhe njerëzit që shkojnë në gjykatë për punë të caktuara...

## KUSH ËSHTË GJYKATËSI?



**GJYKATËSI** është personi më i rëndësishëm në Gjykatë. Gjykatësi mund të jetë femër apo mashkull, i gjatë apo i shkurtër, i ri apo i vjetër. Ai apo ajo mban të veshur mantelin dhe ulet në tavolinën e madhe përballë për tu dalluar nga të tjerët në sallë. Ndonjëherë mund të jenë më shumë se një gjykatës në sallë dhe të gjithë ulen së bashku në një tavolinë.

Gjykatësi ndëgjon me vëmendje atë që thonë të pranishmit në sallën e gjykimit dhe në fund vendos se kush nga personat ka të drejtë sipas Ligjit dhe kush e ka shkelur Ligjin.

Gjykatësi kujdeset për të mbajtur rregullin në sallën e gjykimit. Ai këtë e bën duke e qëlluar tavolinën e tij me çekanin e gjyqtarëve dhe duke u tërhequr vëmendjen të pranishmëve. Kur flet gjykatësi të gjithë personat tjerë në sallë duhet të mbajnë qetësi përndryshe do tu kërkohet të dalin nga salla e gjykimit.

Nëse një fëmijë shkon për të dëshmuar në gjykatë, gjykatësi gjithmonë sigurohet që të gjithë të sillen mirë me të dhe nuk do të lejojë askë ta fyejë apo kërcënoj.

---

### **Ushtrimi nr.2** Rrumbullakëso përgjigjen e saktë.

#### **Për çfarë i shërben çekiçi Gjykatësit?**

- A. Për të ngulur gozhda?
- B. Për të mbajtur rregull në sallën e gjykimit?
- C. Për dekor të tavolinës?



{Për të shikuar përgjigjen e saktë shiko përgjigjen në fund të librit}

## DËSHMITARI

### Kush mund të jetë Dëshmitar dhe Pse?

Njerëzit shkojnë në gjykatë për t'i treguar gjykatësit për atë që kanë parë, atë që kanë dëgjuar apo atë që kanë përjetuar. Këta njerëz quhen **DËSHMITARË**. Dëshmitarë mund të jenë kushdo: të rinjtë, njerëzit e moshuar apo edhe fëmijët. Prandaj edhe ti mund të jesh dëshmitar nëse dikush të ka bërë ndonjë të keqe ty, miqve apo familjes tënde. Gjykatësi nuk e din se çfarë ke parë apo përjetuar ti. Vetëm ti e din këtë. Prandaj, gjykatësi ka nevojë që ti tregosh gjithçka që din në mënyrë që ai të vendos se kush është ai person që e ka shkelur Ligjin.



Në gjykatë do të pyesin pyetje të ndryshme. Disa nga ato do të jenë pyetje se si të quajmë, sa vjeç je dhe a e din dallimin mes të vërtetës dhe gënjeshtërisë. Pyetjet tjera që do të bëjnë do të jenë për të treguar se çfarë ke parë dhe dëgjuar rreth ngjarjes. Nëse nuk e din përgjigjen nuk ke nevojë të mundohesh t'ia qëllosh pa e ditur.

*“Gjëja më e rëndësishme që duhet të bësh në gjykatë është të tregosh të vërtetën”.*



### Mbaj mend!

Si fëmijët ashtu edhe të rriturit mund të kenë emocione të ndryshme kur të shkojnë në gjykatë. Kjo është normale për secilin person. Andaj edhe është mirë që paraprakisht të dish se çfarë do të bësh aty dhe si duhet të sillesh.



### Ushtrimi nr.3

## Fytyrat që tregojnë ndjenjat

Besoj se ti e din se kjo figura këtu quhet “Smiley” që në shqip i bie “I buzëqeshuri”. Ky është një personazh mjaft i dashur për fëmijë. Por po e sheh se Smiley këtu ka disponime të ndryshme. Kjo tregon se në situata të ndryshme ne kemi disponim të ndryshëm.

Detyra yte është të lidhësh me shigjetë figurën me fjalën që përshkruan edhe disponimin e Smiley.



Fig.Nr.1



Fig.Nr.2



Fig.Nr.3



Fig.Nr.4

**I qetë**

**I gëzuar**

**I frikësuar**

**I hutuar**

Pasi kesh identifikuar disponimin e Smiley, tani shkruaj me pak fjalë se si mendon ti, si do të duhej të ndjehet një fëmijë kur të thirret për të shkuar si dëshmitar në gjykatë?

---

---

---

## KUSH JANË PROKURORI DHE AVOKATI?



### **PROKURORI**

Si **prokurori** ashtu edhe **avokati** që të dy janë me profesion Jurist- që do të thotë të dy e kanë të kryer Fakultetin juridik. Megjithatë këta të dy kanë role plotësisht të kundërta. Detyrë e prokurorit është të vërtetoj me prova nëse i dyshimti ka shkelur ligjin. Provat janë dëshmi që i japin gjykatësit informata mbi atë që ka ndodhur. Prové mund të jetë edhe ajo që thotë dëshmitari në gjykatë.

Prokurori duhet të respektojë të drejtat e viktimës. Por prokurori duhet të respektojë edhe të drejtat e të dyshimitit pa marrë parasysh se a është ai apo ajo fajtor apo fajtoare.

### **AVOKATI**


Për dallim nga prokurori detyra e avokatit është të mbrojë të dyshimtin. Ai ka për obligim të sigurohet që i dyshimti të trajtohet mirë. Avokati mbron të dyshimtin duke ofruar prova gjykatës se i dyshimti nuk e ka shkelur Ligjin.

### **Çfarë ndodh nëse ti shkon në Gjykatë për të dëshmuar?**

Nëse ti do të shkosh si dëshmitar në gjykatë duhet të dish se si prokurori ashtu edhe avokati do të bëjnë pyetje gjatë gjykimit dhe ti duhet të përgjigjesh në pyetjet e tyre. Nëse nuk e kupton pyetjen mund të kërkosh që të ta sqarojnë pyetjen edhe njëherë.

# LIDHJA E PIKAVE

Lidh pikat për të parë figurën e plotë.



Pasi të lidhësh pikat shkruaj me fjalë se çfarë figure ka dalë në përfundim?

---

Si do ta emërtosh figurën e fituar?

---

## Kush është viktimia?



**VIKTIMA** është ai person të cilit iu është shkakuar ndonjë dëm apo iu është bërë ndonjë e keqe. Kjo ndodh kur personi tjetër që quhet i dyshimti shkel ligjin. Duke shkelur ligjin ai shkel edhe të drejtat e viktimës duke i shkaktuar ndonjë të keqe atij apo asaj.

Viktimë mund të jetë kushdo: një fëmijë, i rritur, i moshuar, mashkull apo femër.

Viktimat kanë të drejtë të shkojnë në gjykatë dhe ti tregojnë gjykatësit për atë që kanë përjetuar. Për të bërë këtë atyre u ndihmon Prokurori dhe Mbrojtësi i viktimave. Viktima më së miri e din se çfarë ka përjetuar se si ka ndodhur ngjarja.

## Kush është i pandehuri apo i dyshimti?


**I PANDEHURI** apo **I DYSHIMTI** është personi për të cilin mendojmë se ka shkelur ligjin. Ai apo ajo duhet të shkojë në gjykatë pasi që gjykatësi do të vendos nëse ka shkelur ligjin apo jo.

Të dyshimtit në gjykatë i ndihmon avokati i cili ka për detyrë të mbrojë të drejtat e të dyshimtit. Avokati u bën pyetje dëshmitarëve dhe personave tjerë që dëshmojnë para gjykatësit. Në të shumtën e rasteve kur dëshmitari është duke dëshmuar në sallë do të jetë prezent edhe i dyshimti.



Ushtrimi nr.5

**GJEJ CILAT JANË DALLIMET MES FOTOVE TË NGJAJSHME**





## **Oficeri i policisë**

**OFICERI I POLICISË** është personi i cili zakonisht ka kontaktin e parë me personat që kanë shkelur ligjin. Oficerët e policisë janë zakonisht edhe të parët të cilët intervistojnë viktimat dhe dëshmitarët. Oficerët sigurohen gjithnjë që viktimat dhe dëshmitarët të ndihen të sigurtë dhe që i dyshimti të mos i ngacmojë apo kërcënojë ata. Oficerët janë shumë miqësorë dhe i duan shumë fëmijët.

## **Mbrojtësi i viktimave**

**MBROJTËSI I VIKTIMAVE** është aty për ti ndihmuar viktimave për të kuptuar se cilat janë të drejtat e tyre apo çfarë shërbime mund tu ofrohen për të plotësuar nevojat e tyre. Mbrojtësi i viktimave e shoqëron viktimën në gjykatë kur për këtë pajtohet vet viktima. Mbrojtësi i viktimave gjithashtu i shpjegon viktimës se cili do të jetë roli i viktimës kur ftohet për të dëshmuar në gjykatë. Nëse një fëmijë shkon për të dëshmuar në gjykatë, mbrojtësi i viktimave do ti sqarojë më parë çdo gjë rreth rregullave të sjelljes në sallën e gjykimit dhe atë se kush janë njerëzit që do të gjenden në sallën e gjykimit. Është detyrë e mbrojtësit të viktimave që të ju bëj të ndiheni sa më rehat në sallën e gjykimit. Andaj ju mund të kërkoni nga mbrojtësi i viktimave çfarëdo sqarime që ju duhen.



## **Punëtori social**

**PUNËTORI SOCIAL** është personi i cili ka për detyrë të mbrojë në çdo rast interesin e fëmijës. Çdoherë kur në ndonjë rast është i përfshirë edhe një fëmijë atëherë edhe gjatë intervistimit të fëmijës duhet gjithnjë të jetë prezent edhe punëtori social. Ky zyrtar i jep edhe mendimin e vet gjykatës për ruajtjen e mirëqenies së fëmijës.

**Ushtrimi nr.6**

**LOJA ME FJALË**



Renditni fjalët e mëposhtme duke vënë shkrimin e duhur në kuti  
(shiko shemb.nr.1).

**Ç E K I Ç I**

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

--	--	--	--	--	--	--	--

--	--	--	--	--	--	--	--

--	--	--	--	--	--	--

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

**I K E Ç I Ç**

**K U P O R I R O R**

**F I R O C E I**

**T I V A M I K**


**K A G j Y T A**

**D U H A N E R P**

## SALLA E GJYKIMIT

Më poshtë është vizatuar një skicë e sallës së gjykimit. Detyra juaj është që të gjeni vendin se ku duhet ulur secili person i pranishëm në sallë i shënuar me numër më poshtë. Këtë do ta bëni duke shënuar numrin përkatës. Caktimin e vendeve do ta bëni ashtu siq e imagjinoni ju, siq e keni parë në ndonjë film apo në bisedë me dike më të vjetër se ju që mund të ju jap udhëzime.

Pasi të keni bërë vendosjen e numrave diskutoni me shokët për këtë renditje për të parë nëse keni bërë renditjen e duhur.



1. Gjyqtari.
2. Prokurori.
3. Avokati.
4. I dyshimti.
5. Viktima.
6. Dëshmitari.
7. Mbrojtësi i viktimave.
8. Oficeri i policisë.
9. Qytetarë tjerë të interesuar.





## **PROCESI I GJYKIMIT**

Tani pasi mësuam për rolet e disa prej zyrtarëve kryesorë që marrin pjesë në gjykimin e të dyshimitit dhe në mbrojtjen e viktimave, do të përshkruajmë shkurtimisht se si rrjedh e tërë procedura nga fillimi deri në fund. Para se të bëjmë këtë na duhet të ju spjegojmë se përveç personave të përshkruar më lartë në gjykatë punojnë edhe shumë persona të tjerë por për të mos u stërngarkuar më shumë ne kemi përfshirë vetëm ata zyrtarët më kryesorë.

Kur një person shkel ligjin ai person arrestohet nga policia. Zakonisht policia merr informatën për ngjarjen nga njerëz të ndryshëm si p.sh. kalimtar të rastit, fqinjët, viktimat, të afërmit e viktimës apo edhe nga vet i dyshimti etj. Ndonjëherë ndodh që policia të jetë prezente në momentin kur ndodh një vepër prandaj edhe nuk ka nevojë që të presin që ndokush të raportojë për ngjarjen. Policia merr në pyetje të dyshimtin dhe personat e tjerë të përfshirë në rast. Policia pra interviston edhe viktimat dhe dëshmitarët. Më pas policia përgatit një raport dhe e dërgon te prokurori i cili së bashku me policinë mundohen të gjejnë të gjitha provat për të dëshmuar nëse i dyshimti ka shkelur ligjin apo jo.

Pasi të përfundojnë këtë pjesë të punës, prokurori e dërgon rastin komplet në gjykatë. Gjykatësi cakton një seancë në të cilën ftohen të marrin pjesë: prokurori, i pandehuri, avokati i të pandehurit, dëshmitarët, dhe të gjithë tjerët që gjykata mendon se duhet të jenë prezent. Pothuajse të gjitha seancat janë të hapura dhe çdo qytetar mund të marr pjesë në seancë.

Pasi të dëgjojë të gjitha palët, gjykatësi duke u bazuar në provat e paraqitura nga prokurori dhe avokati, vendos nëse i dyshimti është fajtor. Nëse gjykatësi vendos se i dyshimti është fajtor ai i cakton atij dënimin mvarësisht si është dhënë në ligj. I dyshimti mund të dënohet me dënim me burg, dënim me gjobë, dënim me kusht, ndonjë dënim tjetër plotësues apo alternativ apo vetëm ti tërhiqet vërejtja.

## Sqarime për disa shprehje tjera që keni lexuar në përmbledhje:

- **Zyrtarë** - mund të quhen personat e përkthyer më lartë si: Gjykatësi, Prokurori, Oficeri i Policisë, Mbrojtësi i Viktimave, Punëtori Social etj.
- **Vepër** - është veprimi që kryen një person i cili veprim është bërë duke shkelur ligjin.
- **Marrja në pyetje apo intervistimi** - nënkupton kur oficeri i policisë apo edhe zyrtarët tjerë bëjnë pyetje rreth ngjarjes dhe kërkojnë përgjigje. Kjo bëhet me qëllim për të kuptuar më mirë se çfarë ka ndodhur dhe për të gjetur fajtorin.
- **Raport** - Në raport përshkruhet rrjedha e ngjarjes dhe veprimet që kanë ndërmarrë zyrtarët. Kjo bëhet me qëllim që prokurori, gjykatësi dhe të tjerët të kenë më të qartë se çfarë ka ndodhur në rastin konkret.
- **Seancë** - quhet ajo pjesë kur gjykatësi i mbledh të gjitha palët në sallën e gjykimit dhe ku sqarohen në tërësi se si ka ndodhur ngjarja. Mvarësisht nga rasti edhe gjykatësi mund të mbajë më shumë se një seancë për një rast të njëjtë.
- **Dënimi me burg** - e cakton gjykatësi atëherë kur vepra e kryer është shumë e rëndë. Kohëzgjatja e dënimit caktohet me ligj kurse gjykatësi cakton vetëm saktësisht se sa kohë i pandehuri do të qëndroj në burg.
- **Dënimi me kusht** - nënkupton rastin kur gjykatësi cakton dënimin me burg por i pandehuri nuk dërgohet menjëherë në burg. Atij i jepet një afat i caktuar kohor gjatë së cilit ai duhet të sillet mirë dhe nuk duhet të shkel ligjin. Nëse i pandehuri e shkel prapë Ligjin ai do të dërgohet menjëherë në burg.
- **Dënimi me jobë** - e cakton gjykatësi nëse është e paraparë me ligj dhe nëse beson se ky do të jetë i mjaftueshëm për të përmirësuar sjelljen e të pandehurit.
- **Dënimi plotësues** - ndonjëherë gjykatësi bashkë me dënimet e mësipërme të pandehurit mund t'ia caktoj edhe një masë plotësuese p.sh. marrja e patentë shoferit, etj.
- **Dënimi alternativ** - gjykatësi mund të caktojë edhe këtë dënim nëse mendon se do të ndihmojnë në përmirësim të sjelljes së të pandehurit pa i caktuar dënim më të rëndë. Dënim alternativ mund të jetë p.sh. të bëj pastrimin e rrugëve për një kohë të caktuar, apo ndonjë punë tjetër në dobi të shoqërisë, etj.
- **Vërejtje** - Ka raste kur vepra e kryer është shumë më e lehtë, apo kur i pandehuri ka kryer veprën për herë të parë apo nga pakujdesia etj., sa që gjykatësi mendon se është e mjaftueshme nëse të pandehurit vetëm do ti tërhiqet vërejtja për veprën e kryer.

**Loja me kombinime**

Lidh fjalën në kolonën A me fjalinë përkatëse në kolonën B.

**Kolona A**

**Dëshmitari**

**Gjykatësi**

**Seancë**

**Dënimi me kusht**

**Prokurori**

**Mbrojtësi i viktimave**

**Punëtori Social**

**Kolona B**

Personi që dëshmon me prova se i pandehuri ka shkelur Ligjin.

Personi që ka për detyrë të ndihmojë viktimat për të kuptuar se çfarë ndodh kur të mbërrjnë në gjykatë dhe cili do të jetë roli i tyre kur të shkojë në gjykatë.

Personi që u përgjigjet pyetjeve në gjykatë për të treguar si ka ndodhur ngjarja.

Personi i cili dëgjon dëshmitarët dhe vendos nëse i pandehuri është fajtor.

Personi i cili kujdeset për mbrojtjen e interesave të fëmijës.

Kur të pandehurit i caktohet dënimi me burg por nuk dërgohet menjëherë në burg por vetëm nëse ai e shkel prapë Ligjin.

Koha kur gjykatësi i fton në sallën e gjykimit të gjithë personat që kanë njohuri për rastin për të treguar si ka rrjedhur ngjarja.

## PËRGJIGJET NË PYETJET NGA USHTRIMET

### Ushtrimi nr.1

Përgjigje në Porosinë e fshehur të Markut, Tonit dhe Anës

**Fjala e plotë është:**

LEXO ME VËMENDJE GJITHÇKA NË KËTË LIBËR. DO TË FITOSH MË SHUMË NJOHURI PËR LIGJIN DHE GJYKATËN.

---

### Ushtrimi nr.2

Përgjigja e saktë:

B. Për të mbajtur rregull në sallën e gjykimit?

---

### Ushtrimi nr.3

Përgjigja e saktë:

Fig.Nr.1 - I gëzuar

Fig. Nr.2 - I hutuar

Fig. Nr.3 - I frikësuar

Fig. Nr. 4 - I qetë

---

### Ushtrimi nr.6

Përgjigjet e lojës me fjalë:

ÇEKIÇI

PROKUROR

OFICERI

VIKTIMA

GJYKATA

PANDEHURI

---

### Ushtrimi nr.8

Kolona

A1----- B3

A2----- B4

A3----- B7

A4----- B6

A5----- B1

A6----- B2

A7----- B5

